



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16 dhe 142/16”) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 90/15”), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16”) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 34/15”), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 02/2018

për punësimin e 1 nëpunësve publik nga grupi I, nëngrupi II në „Institutin e Akreditimit të Republikës së Maqedonisë “për vendet e punës në vijim:

1. AKR0102V01005 Këshilltar - Koordinator për akreditimin e laboratorëve mjekësorë, Njësia për akreditimin e laboratorëve mjekësorë, Sektori për akreditimin e laboratorëve. 1 realizues(ë)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveu i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Teknologji kimike, Biologji, Mjekësi Veterinare
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht) përmes posedimit të çertifikatës të pranuar ndërkombtarisht e të lëshuar nga testatorët oficialë evropianë, anëtarë të asociacionit ALTE të testatorëve evropianë të nivelit A2 të CEFR, përkatësisht KET, IELTS me 3 pikë maksimum, BULATS, ose TOEFL PBT së paku 400 pikë, TOEFL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF ose çertifikatë Gete.
- njohja e gjuhës angleze mund të dëshmohet edhe me dorëzim të çertifikatës së pranuar ndërkombëtarisht nga STANAG 6001 standarde të NATO-s në nivelin përkatës, ku nëpunësit administrativë nga kategoria V duhet të posedojnë çertifikat me STANAG 1+1+1+1+
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
- Rroga neto: 24.945,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Faza e 4 – të: Testi i personalitetit realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të fazës së 3 – të.